



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 26 .03.2019

RAPORT

PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2018

Në referim të nenit 31¹, pika 3 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), raportoi në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2018.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e zhvilluar në datën 6 mars, mori në shqyrtim raportin vjetor për veprimtarinë e Institucionit të KDIMDP, bazuar në nenin 18² dhe 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Për parashtrimin dhe prezatimin e këtij raporti, si dhe për ti dhënë përgjigje pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, në mbledhje ishte i pranishëm, Z. Besnik Dervishi dhe përfaqësues të këtij Institucioni.

¹ Komisioneri paraqet raport vjetor përpara Kuvendit dhe raporton përpara tij sa herë i kërkohet. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme.

² Komisionet e përhershme të Kuvendit shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrave dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta.

I. Detyrat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kompetencat e Zyrës së Komisionerit lidhur me të drejtën e informimit, renditen si më poshtë:

- ✓ Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- ✓ Ankimi administrativ pranë Komisionerit bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: (i) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; (ii) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.(10 ditë pune).
- ✓ Me marrjen e ankesës, Komisioneri verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
- ✓ Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

Kompetencat e Zyrës së Komisionerit lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale janë:

- ✓ Trajton ankesat e subjekteve të adresuara pranë Zyrës së Komisionerit;
- ✓ Kryen hetime administrative në kontrollues publik e privat (me iniciativë ose mbi bazë ankese), mbi përpunimin e të dhënave personale në përputhje me ligjin nr.9887/2008“Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative;
- ✓ Ndjek dhe zhvillon seanca dëgjimore me kontrolluesit si dhe propozon në çdo përfundim shqyrtimi, marrjen e masave në përputhje me kompetencat e Komisionerit (rekomandim, vendim, urdhër);
- ✓ Verifikon zbatimin e rekomandimeve;
- ✓ Regjistron Kontrolluesit (formulari i njoftimit) në “Regjistrin elektronik të kontrolluesve” – i aksesueshëm pjesërisht për publikun në faqen online të IDP;
- ✓ Trajton kërkesat për transferime ndërkombëtare të të dhënave;
- ✓ Jep mendime dhe opinione ligjore lidhur me mënyrën e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Trajton kontrollues publik dhe privat dhe grupet e interesit (organizata) që mbrojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave

II. ARRITJE TË EVINDETUARA

Në analizë të raportit vjetor të Komisionerit për vitin 2018, arritjet e evidentuara, referohen si më poshtë :

Lidhur me monitorimin dhe zbatimin e Ligjit Nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar, rezulton se :

- Janë paraqitur 245 ankesa, kryesisht lidhur me : Cënimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, përhapjen/transmetimin e të dhënave personale pa pëlqimin e subjektit të të dhënave personale si dhe në persona të paautorizuar, për të mbrojtur të dhënat personale; përpunimin e të dhënave në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme (përhapja në mediat dhe portalet online); vendosjene kamerave në ambiente publike dhe private; marketingun e drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike; tejkalimin e afatit të mbledhjes së të dhënave personale për një qëllim të caktuar.
- Janë realizuar 190 inspektive administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm publikë dhe privatë, kryesisht në fushat e arsimit, të shëndetësisë, në sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura; sektorin e vlerësimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme; në sektorin e shërbimit postar.
- Në mbyllje të procedurave hetimore Zyra e Komisionerit ka dhënë 30 vendime, të cilat korrespondojnë me 61 sanksione administrative të vendosura.
- Janë dhënë 29 Rekomandime për kontrollues publik dhe privat.
- Është ushtruar hetim administrative në kuadër të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të viteve 2016-2017. Nga 103 rekomandime të lëna në këto vite në kontrollues privat dhe publik, një numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë reaguar duke dërguar informacion me përmbushjen e detyrimeve.
- Janë trajtuar 14 praktika për autorizimin e transferimit ndërkombëtar në disa shtete pa nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe janë dhënë 2 vendime për lejimin e transferimit ndërkombëtar në disa sektorë, si bankat dhe në fushën farmaceutike.

Lidhur me monitorimin dhe zbatimin e Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rezulton :

- Gjatë vitit 2018, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan 820 ankesa, prej të cilave 622 janë zgjidhur me ndërmjetësim. Për 37 nga këto ankesa, Komisioneri është shprehur me vendim, 116 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, 9 ankesa kanë qenë jashtë afatit, 17 ankesa kanë rezultuar të paplota dhe 24 ankesa vijnë në proces.

- Janë realizuar 93 hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Janë dërguar pranë autoriteteve publike 195 kërkesa për parashtrime, ndërsa 24 ankesa vijnë në proces.
- Janë dhënë 37 vendime për autoritetet publike, prej të cilave 30 vendime urdhërimi, 3 vendime rrëzimi, si dhe 4 vendime me sanksion gjorbë. Gjatë këtij viti janë realizuar 29 seanca dëgjimore.
- Me anë të V.K.M Nr.145, datë 13.03.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit” u miratua krijimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve, i cili u instalua në 27 institucione qendrore .
- Numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit është 237 në periudhën mars – dhjetor 2018, ndërsa në po të njëjtën periudhë numri i ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit është 50 në total.

III. ÇËSHTJE TË TRAJTUARA GJATË RAPORTIMIT TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të raportit vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga anëtarët e Komisionit u shtruan për diskutim disa çështje në lidhje me veprimtarinë e Komisionerit dhe u evidentuan disa problematika, të renditura si më poshtë :

- Vihet re një përmirësim optimal, përse i përket problematikave të hasura në institucionet e pushtetit vendor, me ndërtimin e faqeve të internetit çka sjell lehtësi në aksesimin e informacionit;
- Pjesa më e madhe e bashkive kanë publikuar programin e transparencës, por informacioni nuk është i përditësuar apo i linkuar, sikurse parashikohet në ligj. Konkretisht një nga informacionet që vijon të mos publikohet është ai që lidhet me buxhetin, prokurimet dhe raportet e auditimit;
- Disa bashki kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, por problematik mbetet përditësimi i tij.
- Programet e transparencës nuk janë të përditësuara dhe mungon një pjesë e dokumenteve të cilat duhet të jenë të publikuara, në kuptim të nenit 7, të Ligjit “Për të drejtën e informimit”. Një nga informacionet që vijon të mos publikohet është ai që lidhet me buxhetin, prokurimet dhe raportet e auditimit;

- Konstatohet se koordinatorët për të drejtën e informimit, janë në nivel specialisti dhe kanë akses të limituar në strukturat e tjera të ministrisë. Kjo sjell vështirësi në vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 10 ditor.
- Gjithashtu, janë konstatuar raste kur kërkesat për informacion nuk kalojnë tek koordinatori, por delegohen në struktura të tjera të ministrisë, duke u trajtuar njësoj si shkresat e tjera, që lidhen me aktivitetin e përditshëm të autoritetit publik.
- Koordinatorët e të drejtës për informim nuk zotërojnë njohuritë e mjaftueshme për kuadrin ligjor, çka sjell që zbatimi i këtij ligji të mos jetë në nivelin e duhur. Ky fakt bëhet pengesë dhe për rolin që ato duhet të luajnë lidhur me koordinimin e mbledhjes së informacionit.
- Vazhdon të jetë e ulët ndjeshmëria dhe angazhimi qytetar, lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Gjatë vitit 2018, janë trajtuar vetëm 3 ankesa, në të cilat ankuesit kanë pretenduar në mos konsultimin e projekteve me publikun.
- Të përfshihet me aq sa është e mundur Komisioneri për të pasur rol aktiv në rregullimin e veprimtarisë së medias online, duke siguruar informacion publik proaktiv nga autoritetet publike, në respekt dhe garantim të parimeve dhe legjislacionit për privatësinë

IV. PËRFUNDIME TË RAPORTIT

Komisioni i Ligjeve, pas shqyrtimit të raportimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit si dhe shpjegimeve të dhëna nga Komisioneri në mbledhjen e Komisionit, vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për vitin 2018, në këto drejtime kryesore :

së pari : Rolin e veçantë të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), si institucion i pavarur dhe përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe për nxitjen e standardeve më të larta në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që ka në thelb të fushës së veprimtarisë së tij;

së dyti : Zhvillimin pozitiv që po merr ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe duke inkurajuar e mbështetur këtë institucion, në rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve publike dhe kontrolluesve publikë e privatë për detyrimet e tyre mbi transparencën dhe llogaridhënien në kuadër të të drejtës për informim por edhe ruajtjes së jetës private, si dhe duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

së treti : Rolin aktiv të Zyrës së Komisionerit në rritjen e ndërgjegjësimit të Autoriteteve Publike për detyrimet e tyre mbi hartimin dhe publikimin e programeve të transparencës dhe dhënien e informacionit publik;

së katërti : Rolin e këtij institucioni në arenën ndërkombëtare, dhe duke vlerësuar në këtë aspekt, zgjedhjen e Zyrës së Komisionerit në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë ICDPPC, si dhe konfirmimin e tij si anëtar vëzhgues në Bordin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në formatin e tij të ri si organ vendimarrës i Bashkimit Evropian në kuadër të Rregullores 2016/679 të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR).

Referuar në problematikat e trajtuara gjatë këtij raportimi, Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe Të Drejtat e Njeriut, i rekomandon Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019 :

- Të thellojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, mbiplanintematik duke synuar rritjen e kontrollit mbivëprimtarinë e administratës publike, për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesin në informacion.
- Të monitorojë përditësimin e programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, nga autoritetet publike, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit vendor.
- Të investohet për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, që administrohet nga autoritetet publike.
- Të zhvillohet mbi plan tematik procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke synuar minimizimin e shkeljeve të ligjit, respektimin e privatësisë dhe përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale.
- Të mbikëqyrë kontrolluesit publik dhe privat mbi zbatimin e detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave në lidhje me të drejtat e tyre, qëllimin e përpunimit, publikimin e politikave të privatësisë në faqet e tyre online.
- Të rrisë numrin e masave administrative për shkelje ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.
- Të përfshihet për të pasur rol aktiv në rregullimin e veprimtarisë së medias online, duke siguruar informacion publik proaktiv nga autoritetet publike, në respekt dhe garantim të parimeve dhe legjislacionit për privatësinë.

- Të forcojë marrëdhëniet bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e dy fushave të veprimtarisë së institucionit dhe organizimin e trajnimeve.
- Të vijojë të luajë rol aktiv në favor të proceseve integruese të vendit, në përmbushje të funksionit të anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë ICDPPC si dhe atij të vëzhguesit në Bordin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.
- Të asistojë në hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me legjislacionin përkatës të BE-së, konkretisht me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Direktiva për mbrojtjen e të dhënave të personave fizikë gjatë procesit penal).
- Të intensifikojë dhe të nxisë punën në përmbushjen e plotë të detyrimeve ndërkombëtare mbi ratifikimin dhe nënshkrimin e Protokollit Shtesë të Konventës 108+ “Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”.
- Të vijojë aktivitetet informuese e sensibilizuese mbi edukimin e të rinjve për të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale .

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 26.3.2019, pas diskutimeve të zhvilluara nga deputetët dhe relatori i çështjes, deputete Elena Xhina, miratoi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, projekt-rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” për vitin 2018, të cilën ja paraqet për votim seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëlidhur raportit të “Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, projekt-rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” për vitin 2018.

Relator

Elena XHINA

KRYETAR

Ulsi MANJA

